



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 451-20362 /2019

Klinë, dt.22/05/2019

Duke u bazuar ne neni 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040 i publikuar në gazetën zyrtare më dt.04.06.2008, nr.28/2008, dispozitat e nenit 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nr.05/L-031, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës të dt.31.03.2010, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave, nr.04-451-19833/2019 të dt.20.05.2019, kryetari i Komunës së Klinës, më dt.22/05/2019, merr këtë;

V E N D I M

Për anulimin e konkursit për ndarjen e bursave për student të Komunës së Klinës, nr.04-451-8285/2018 të datës 10.12.2018

- I. **ANULOHE**T, në tërësi konkursi për ndarjen e bursave për studente të Komunës së Klinës, nr.04-451-8285/2018 i shpallur nga Drejtoria komunale e Arsimit më datën 10.12.2018, si dhe njoftimi i DKA-së për shpalljen e rezultateve, nr.79/2019 i dt.19.02.2019 së bashku me listën e komisionit përzgjedhës të përfituesve të bursave komunale.
- II. **OBLIGO**HET, Drejtoria Komunale e Arsimit të bëjë njoftimin e anulimit të konkursit si dhe Rishpalljen e konkursit për ndarjen e bursave.
- III. E gjithë procedura anulohet në baze të vendimit të komisionit të ankesave i cili ka vlerësuar dhe konstatuar se kemi të bëjmë me shkelje të kushteve dhe kritereve të parapara më dispozita të rregullores komunale për ndarjen e bursave, i cili ka sugjeruar anulimin e këtij konkursi.
- IV. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- DKA;
- Zyra e informimit;
- Ekzekutivi;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj